



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 10935 prot.

Shkodër, më 30 . 5 . 2025

VENDIM

Nr. 33, datë 29.05.2025

“PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2025 E MIRATUAR ME "VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.76, DATË 19.12.2024 ‘PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2025-2027 TË BASHKISË SHKODËR’ I NDRYSHUAR”

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 29.05.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në: ligjin 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54 shkronja ‘dh’; ligjin nr.45/2019 “Per Mbrojtjen Civile”, VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; VKM-në nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondeve të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”, i ndryshuar, neni 3, pika 3.1, germat a,b,dh; ligji nr.68/2017, “Për financat vendore”, i ndryshuar; Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; shkresën nr.492/1 prot., datë 25.02.2025 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, e Ministrisë së Mbrojtjes/Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”; shkresën nr.4804/1 prot., datë 28.02.2025 “Kthim përgjigje Ministrisë së Mbrojtjes/Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për shkresën me nr. 492/1 prot., datë 25.02.2025 me objekt “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, nga Bashkia Shkodër ; VKB-në nr. 76 , datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar; si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratoje shtesën e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2025, të alokuar në programin AB141 – Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile, art.604, në vlerën **21,907,271.74** lekë, te detajuar si më poshtë:
 - a. Për Kod produkti 91707AG – “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve”, në vlerën **6,000,000 lekë**.
 - b. Për Kod produkti 91707AB-“Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”, në vlerën **15,907,271.74** lekë.
2. Të miratojë “shpenzimet për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve”, me kod produkti 91707AG me vlerë 6,000,000 lekë si më poshtë:
 - a. “Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të Qytetit dhe Njësive Administrative, Bashkia Shkodër”, me vlerë **6,000,000 lekë**.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 33 vota

Vota Pro	33
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	30.05.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULI

